



KOMISIONI RREGULLATOR I ENERGETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË UJIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



NJOFTIM PËR OPINIONIN

Marko Bislimoski, kryetari i Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit, së bashku me komisarët, kanë mbajtur mbledhje pune me Oto Grafina, zëvendësambasadorin e Republikës Federale të Gjermanisë.

Bashkëbiseduesit u pajtuan se pavarësia energjetike është kyçe dhe e njëjta sigurohet përmes investimeve të vazhdueshme në sektor.

Kryetari Bislimoski i informoi se sistemi energjetik ka qenë stabil gjatë periudhës së gjendjes së jashtëzakonshme, por edhe tani dëshmon se është i qëndrueshëm ndaj krizës aktuale shëndetësore-ekonomike, e cila është rezultat i rregullimit cilësor të sektorit energjetik, ku mirren parasysh të gjithë parametrat e punës së kompanive energjetike, në përputhje me rregulloren ligjore.

"Për ne, prioritet është dërgesa e sigurtë dhe stabile e energjisë elektrike dhe termike te qytetarët. Duke punuar në rregulloren, të cilën e harmonizuam me legjislacionin e UE me udhëzime nga Komiteti Energjetik, kemi paraparë edhe pjesë të veçantë për konsumatorët e ndjeshëm, të cilët janë të mbrojtur në këta muaj të dimrit. Gjegjesisht, furnizuesi gjatë muajve të dimrit, respektivisht dhjetor, janar dhe shkurt, nuk guxon t'i shkyçë konsumatorët e ndjeshëm për shkak të faturave të papaguara. Është dëshmuar se mekanizmi për mbrojtjen e konsumatorëve të ndjeshëm, që është praktikë e UE është i rëndësishëm në këtë kohë të krizës shëndetësore-ekonomike", theksoi Bislimoski.

Ai ceku se KRRE punon në mënyrë të fokusuar në hartëzimin e qytetit sa i përket ngrohjes, për çka kanë filluar konsultimet edhe me odat ndërtimore.

Z. Grafi e faleminderoi për pritjen në KRRE dhe për bisedën për çështjet rregullatore në Maqedoninë e Veriut, para së gjithash sa i përket procesit të bashkëngjitjes në UE, si dhe rëndësinë e tyre për investitorët.

Sa i përket aktiviteteve të ardhshme, një ndër sfidat e KRRE-së do të jetë edhe mbiformimi i rregullores në lidhje me dërgesën e gazit në pritje të rezultatit nga tenderi i publikuar i gazifikimit në vend, si dhe realizimi i projekteve që janë paralajmëruar rishtas për ndërtimin e terminalit të gazit natyror afër Aleksandropolisit në Greqi.

16.10.2020

